

REALIZIMI I TREGUESVE EKONOMIKO-FINANCIAR

Realizimi i treguesve të mësipërm analizohet duke u bazuar në vendimin nr.1, datë 15 Shkurt 2019 «Mbi miratimin e buxhetit të RTSH-së » për vitin 2019, Vendimin Nr.38, datë 15.11.2019 të Këshillit Drejtues RTSH «Për miratimin e ndryshimeve në Buxhetin e RTSH-së për vitin 2019», si edhe Aktit Normativ nr.11, datë 24.12.2019, mbërritur në RTSH më datë 31.12.2019, sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr.24136/6, datë 31.12.2019 për shtesë fondi në zërin investime kapitale.

Realizimi i të ardhurave gjatë vitit 2019

Në mënyrë të përmbledhur, të ardhurat sipas burimeve të financimit janë realizuar në raportet dhe në strukturën e mëposhtme:


- Të ardhura tarifa aparatit TV	në vlerën	1,249,405,000 lekë (~ 56 % ndaj totalit)
- Të ardhura të financuara nga Buxheti i Shtetit	në vlerën	674,000,000 lekë (~ 30% ndaj totalit)
-Të ardhura të vetë RTSH	në vlerën	303,227,000 lekë (~ 14 % ndaj totalit)

A. Realizimi i të ardhurave në krahasim me planifikimin gjatë vitit 2019

Të ardhurat	Plani Buxhetit Viti 2019	Realizimi Viti 2019	Realizimi në %
I. Financimi nga buxheti	674,000,000	674,000,000	100
Bashkatdhetarët&Sateliti	240,000,000	240,000,000	100
Projekte Filmike&Artistike	74,000,000	74,000,000	100
Orkestra Simfonike RTSH	60,000,000	60,000,000	100
Shërbim mirëmbajtje rrjeti digj.etj.	200,000,000	200,000,000	100
Investime në Teknologji	100,000,000	100,000,000	100
II.Të ardhura nga tarifa ap.tv	1,400,000,000	1,249,405,000	90
III.Të ardhura të Institucionit	375,000,000	303,227,000	81
Shfrytëzim infrastrukture transmetimi	147,000,000	85,903,000	58
Reklama,njoftime etj.	95,000,000	83,824,000	88
Të ardhura Kontrata me Kinën	76,000,000	76,000,000	100
Të ardhura të tjera	57,000,000	57,500,000	100
TOTALI I+II+III	2,449,000,000	2,226,632,000	91%

Të ardhurat janë realizuar në masën 91%, ose në vlerën 222,368,000 lekë më pak në krahasim me planifikimin, kryesisht nga tarifa e aparatit TV dhe shfrytëzimi i infrastrukturës transmetuese RTSH, dy burimet kryesore që ishin parashikuar si mbështetje e rëndësishme financiare në kuadër të nisjes dhe vazhdimësisë së procesit të digjitalizimit.

Grafiku i të ardhurave RTSH



Në mënyrë analitike realizimi i të ardhurave paraqitet:

I - Të ardhurat nga buxheti janë realizuar në nivelin e parashikuar.

a) Në Programin e parë «Bashkatdhetarët dhe Shërbimi Satelitor», në zbatim të nenit 116/a, b, c të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili shprehimisht përcakton “Financimi nga Buxheti i Shtetit” përfshin:

- a) shërbimin e transmetimeve audio për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;*
- b) shërbimin e transmetimeve audio për publikun e huaj;*
- c) shërbimin e transmetimeve audiovizive për shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;*

është tërhequr financimi në vlerën totale 240,000,000 lekë, bazuar në situacionet mujore nga njësitë e strukturave që kryejnë këto shërbime, si edhe pagesat e kryera për tarifën e shërbimit satelitor për Eutelsat ,Ses Astra etj.

b) Në Programin e dytë «Orkestra Simfonike e RTSH-së», në zbatim të nenit 116/dh të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili shprehimisht përcakton “Financimi nga Buxheti i Shtetit” përfshin:

dh) orkestrën simfonike të RTSH-së dhe kinematografisë,

është tërhequr financimi në vlerë totale 60,000,000 lekë, bazuar në situacionet mujore për paga, sigurime shoqerore.

c) Në Programin « Projekte Filmike e Artistike », në zbatim të nenit 116/d të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili shprehimisht përcakton “Financimi nga Buxheti i Shtetit” përfshin:

d) Projekte të rëndësishme prodhimi filmik dhe veprimtari artistike të mëdha mbarëkombëtare, të prodhuara nga RTSH-ja;

është tërhequr financimi buxhetor në vlerën totale 74,000,000 lekë, nga të cilat vlera 65 milion lekë për aktivitetet si vijojnë: Eurosong 2019, Festivali Junior Eurovision 2019, Festivalin e 57-të Këngës në RTSH, Serial TV “Njerka”, seriale radiofonike, programet festive të fundvitit, si edhe një aktivitet i festave të nëntorit dhe dokumentari në kuadër të 100 vjetorit të parlamentarizmit shqiptar, financuar nga buxheti i shtetit në vlerën 9 milion lekë (shesë e buxhetit gjatë vitit 2019).

d) Në Programin «Projekteve Teknike për futjen e Teknologjive të reja», në zbatim të nenit 116/ ç të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i cili shprehimisht përcakton “Financimi nga Buxheti i Shtetit” përfshin:

ç) projekte të rëndësishme teknike për futjen e teknologjive të reja për prodhim dhe transmetim; parashikuar si vijon:

d.1) **Investime në Teknologji në vlerën 100,000,000 lekë është realizuar 100%**. Investimet e parashikuara gjatë vitit 2019 përfshijnë: Investime në Teknologji për furnizim vendosje depozita karburanti dhe sisteme monitorimi të pikave të transmetimit të rrjetit DVB-T2 në vlerën 28,6 milion lekë dhe vlera tjetër është përdorur për të likuiduar detyrimin që mbart RTSH nga viti 2018 për RTSH AGRO. Në fund të muajit dhjetor 2019, RTSH u financua nga Buxheti me një shtesë 50 milion lekë për të likuiduar pjesërisht detyrimin.


d.2) **Shpenzime për shërbimin e mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit etj. në vlerën 200,000,000 lekë**, nëpërmjet të cilës është likuiduar detyrimi kontraktor për shërbimin e mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit gjatë vitit 2019, si edhe likuidimi pjesor i këstit të kredisë së digjitalizimit.

Ndonëse të gjithë zerrat e financimit janë realizuar 100%, theksojmë këtu se shpenzimet e RTSH-së për keto programe janë në vlera më të larta dhe përballë faktit të domosdoshmërisë së kryerjes së tyre, RTSH i është dashur ta përballojë nga fondet e të ardhurave të veta diferencat e pambuluara nga financimi buxhetor.

II. E ardhura nga tarifa e aparatit TV

Mosrealizimi në vlerën ~150.6 milion lekë vjen si rezultat i arkëtimit të tarifës jo në nivelin e planifikuar.

Tarifa e aparatit televiziv është realizuar në nivelin 90% gjatë vitit 2019, ose e shprehur në vlerë absolute 150,595,000 lekë më e ulët nga planifikimi. Arkëtimi i kësaj të ardhure ka përbërë burimin kryesor të të ardhurave të RTSH-së, si persa i përket vlerës mujore, ashtu edhe kronologjisë së arkëtimit brenda afateve të parashikuara.



Nëpërmjet paraqitjes grafike është pasqyruar arkëtimi në fakt në vitin 2019. Planifikimi i kësaj të ardhure u bë në vlerën ~117 milion lekë në muaj, nisur nga numri i abonenteve, si edhe përfshirja e përdoruesve jofamiljare për çdo aparat TV (shërbimet e hotelerisë) siç e kanë të përcaktuar aktet nënligjore. Si rezultat i vijimit të të njëjtës situatë faturimi nga OSHEE, megjithë shkresat e derguara nga RTSH, në asnjë muaj vlera e tarifës nuk arriti nivelin e

planifikuar. Vetëm në muajt Janar e Shtator rezultojnë vlera arkëtimi mbi 110 milion lekë dhe muajt Mars, Korrik e Nentor rezultojnë me nivelet më të ulëta të arketimit në vlerat 97-98 milion lekë.

III - Të ardhurat e realizuara nga vetë RTSH kanë patur ecurinë si vijon:

1. Të ardhurat nga shfrytëzimi i infrastrukturës transmetuese të RTSH dhe transmetime FM janë realizuar në masën ~58%, ose me një mungesë në vlerë absolute ~61 milion lekë.

Kjo mungesë vjen nga mosrealizimi i të ardhurave nga shërbimet në rrjetin numerik:

- AMA ka shtyrë afatin e mbylljes së transmetimeve analoge tre here brenda vitit 2019, sidomos në Tiranë, vlerë e cila ishte parashikuar të realizohej gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2019 dhe u realizua vetëm në muajin shtator 2019, e deri në fund të vitit është faturuar shërbimi vetëm për 4 allotmente nga 11 allotmente gjithsej.

2. Në zërin e reklamave, njoftimeve etj, gjatë kësaj periudhe ka një realizim në masën 88 %, një mungesë realizimi në vlerë absolute ~11 milion lekë. Gjatë vitit 2019, realizimi i këtyre të ardhurave ka patur problematikat e veta. Vlerat e realizimit të këtij zëri gjatë tremujorit të parë dhe në muajin Korrik kanë qenë në kufijtë minimalë 2,4-3,6 milion lekë, ndërkohë që situatat më të mira janë ato të muajve gusht, nëntor e dhjetor 2019, me realizime në vlerat 8-17,9 milion lekë. Kontratat për ripërsëritjen e transmetimit nga subjektet kabllore, sipas vendimit të Këshillit Drejtues të vitit 2018 janë në vlerën 3,566,832 lekë.

Vlera e kontratave me klering, kundrejt totalit të kontratave realizuar gjatë vitit 2019 është ~ 17 milion lekë.

3. Në zërin e të ardhurave të tjera të RTSH-së, gjatë kësaj periudhe ka një realizim në masën vetëm 82%. Në këtë zë janë përfshirë të ardhurat nga klikimet e kanaleve të RTSH-së në Youtube, shitja e materialeve arkivore, të ardhura nga kontratat e qirasë së lokalit, pajisjeve dhe studiove, nga rimbursimi i shpenzimeve të Radiostacionit të Cërrikut, për detyrime nga kontrata e radio-bashkëpunimit në valë të shkurtra midis Koorporatës së Përgjithshme të Radio Televizionit të Kinës për Bashkëpunimin Ndërkombëtar Tekniko-Ekonomik dhe Drejtorisë së Stacioneve Transmetuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Radio Televizionit, shitja e biletave etj.

4. Të ardhura nga Koorporata e Përgjithshme e Radio-Televizionit të Kinës për bashkëpunim Ndërkombëtar Tekniko-Ekonomik. Bazuar në Kontraten e RadioBashkëpunimit në valë të shkurtra midis Shqiperisë dhe Kinës, është realizuar 100% vlera e parashikuar në kontratë prej 700,000 USD gjatë vitit 2019, përfshirë këtu edhe vlera 150,000 USD në formën e grantit, e cila u përdor për pajisje, sipas kërkesave të njësive të vartësisë.

Krahasimi i të ardhurave gjatë tre viteve të fundit

TE ARDHURAT	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
I. Financimi nga buxheti	865,000,000	665,000,000	674,000,000
Sherbimi për shqiptaret jashtë kufirit	245,000,000	240,000,000	240,000,000
Prodhime filmike, veprimt. artistike mbarekombetare	63,000,000	65,000,000	74,000,000
Orkestra Simfonike RTSH-se dhe kinematografise	57,000,000	60,000,000	60,000,000
Projekte teknike për futjen e teknologjive reja	500,000,000	300,000,000	200,000,000
II. Të ardhura nga tarifa ap.tv	1,282,683,000	1,200,830,000	1,249,405,000
III. Të ardhura të Institucionit	508,865,000	507,490,000	303,227,000
Te ardh. Shfrytëzimi i Infrastruktures Transmetuese	44,200,000	60,170,000	85,903,000
Reklama, njoftime, etj.	76,600,000	205,320,000	83,824,000

Kontrata e Radiobashkëpunimit me Kinën	80,000,000	76,000,000	76,000,000
Të ardhura nga shitja produkteve te veta dhe te ardhura te tjera	41,000,000	41,000,000	57,500,000
Të ardhura të trashëguara nga vitet e kaluara	266,153,000	125,000,000	-
TOTALI I+II+III	2,657,460,000	2,373,320,000	2,226,632,000

Të ardhurat gjatë tre viteve të fundit paraqiten me trendin në ulje në total, rrjedhojë kjo kryesisht nga rënia e të ardhurave të trashëguara nga vitet e kaluara. Duke zbritur të ardhurat e trashëguara në vite, të ardhurat qëndrojnë në të njëjtin nivel.

- Niveli mesatar i arkëtimit të tarifës së aparatit vetëm për abonentet familjare gjatë tre viteve të fundit arrin vlerën 1,245,000,000 lekë.

- Të ardhurat nga financimi buxhetor, kryesisht për investime, qëndrojnë në nivele më të ulëta, edhe zërat e tjerë të financimit nuk i mbulojnë plotësisht, por vetëm pjesërisht shpenzimet që bën RTSH aktualisht.

- Të ardhurat nga shfrytëzimi i infrastrukturës transmetuese, ndonëse paraqiten me rritje nga një vit në tjetrin, nuk kanë arritur parashikimin në zbatim të strategjise dhe kontrates së digjitalizimit, si rezultat i vonësive dhe shtyrjeve të vazhdueshme të mbylljes së transmetimeve analoge.

Në kushtet kur RTSH përballë me kostot tepër të larta të procesit të digjitalizimit, shtimit të numrit të kanaleve të transmetimit e larmshmërisë së programacionit, mosrealizimi i të ardhurave të parashikuara në buxhet krijon vështirësi në aftësinë paguese të RTSH-së.

Duke vlerësuar mbështetjen e buxhetit të shtetit gjatë tre viteve të fundit, në mënyrë të veçantë për vitin 2017, do të theksonim faktin që kjo mbështetje është e domosdoshme për sa kohë:


- tarifa e aparatit (100 lekë në muaj, ose 1,200 lekë/vit) mbetet e pandryshuar,
- vlera e faturimit të saj nuk është transparente, si edhe
- përqindja që mbahet aktualisht nga OSHEE (10%) nuk ulet në nivelin 2%, sipas kërkesave të vazhdueshme të RTSH-së.

II. Realizimi i shpenzimeve në krahasim me planifikimin gjatë vitit 2019

Nr.	Emërtimi	Planifikimi Viti 2019	Realizimi Viti 2019	Realizimi ne %
1	Paga,shpërblime ,sig.shoqëror	798,150,000	783,440,000	98%
2	Materiale,lënde djegëse	66,500,000	64,785,000	97%
3	Projekte filmike,artist.etj	339,000,000	338,287,000	99 %
4	Organizma Ndërkombëtarë	87,000,000	86,967,000	99%
5	Shërbime nga të tretë	235,050,000	233,961,000	99%
6	Shpenzime udhëtimi e dieta	86,500,000	86,498,000	99%
7	Shpenzime të tjera operative	61,800,000	60,811,000	98%
8	Investime	200,000,000	198,684,000	99%

8.1	Shpenz. Mirëmbajtje rrjeti digjitalizimi	245,000,000	245,000,000	100%
9	Shpenzime për interesa dhe këste kredie	330,000,000	326,000,000	99
	TOTALI	2,449,000,000	2,424,433,000	98.9%

Struktura e shpenzimeve në mënyrë grafike në përqindje paraqitet si vijon:



Në tabelën dhe grafikun e mësipërm është përfshirë edhe vlera ~325 milion lekë këste kredje, që u likuiduan nga Ministria e Financave, si garantuese e kredisë, për shkak të mungesës së aftësisë likuiduese të RTSH-së.

Në mënyrë analitike realizimi i çdo zëri shpenzimi paraqitet si vijon:

- Zëri paga, sigurime shoqërore e shpërblime është realizuar 99%.

Gjatë vitit 2019 janë reflektuar ndryshimet strukturore, janë bërë ndryshimet brenda për brenda zërave të shpenzimeve për paga, në zbatim të vendimeve të Keshillit Drejtues RTSH. Niveli i pagave sipas kategorive ka mbetur i njëjtë.

Nga muaji Prill i vitit 2013 nuk është bërë asnjë rritje e pagave të punonjësve të RTSH-së, si rezultat i mungesës së burimeve financiare (përfshirë këtu vetëm formacionin e Orkestres, i cili ka përfituar një rritje page 13% nga 1 marsi 2017).


Nga 930 punonjës në fillim të vitit 2019, numri mesatar i punonjësve në fund të vitit 2019 ishte 906.

RTSH mbajti gjithë kohën nën kontroll çdo ndryshim strukturore, si në personelin edhe në kategoritë pagash, sipas planifikuar gjatë vitit 2019.

Paga mesatare e punonjësve gjatë vitit 2019 ishte ~56,170 leke.

- Zëri Materiale përfshin shpenzimet për blerjen e materialeve kryesore teknike, materiale ndihmëse, lëndë djegëse (karburant) është realizuar 99%.

Realizimi i këtij zeri është në nivelin 99% dhe është kryer nëpërqindjen më të lartë në njësinë Teknike dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të RTSH-së, duke i shërbyer të gjitha strukturave të vartësise në mënyre sa më efikase.



- Zëri i Projekteve Filmike dhe Artistike & Fondi i Prodhimit të Pavarur.

Në këtë zë përfshin:

a) të gjitha shpenzimet për blerjen e të drejtave të transmetimit, dokumentarë, filma, programe sportive, artistike, dhe është realizuar 100% në vlerën e parashikuar 338,000,000 lekë.

b) shpenzimet për fondin e prodhimit të pavarur, nuk janë realizuar gjatë vitit 2019. Kjo edhe për faktin që situata e vështirë financiare bëri që të shfrytëzohej kryesisht fondi i projekteve filmike e artistike.



Gjatë vitit 2019 janë realizuar blerje të drejtash TV, të drejta transmetimi të programeve e aktiviteteve të ndryshme artistike dhe sportive, etj në vlerën 135 milion lekë, si edhe prodhime dhe bashkëprodhime në vlerën 203 milion lekë, duke vënë në shërbim të platformave të transmetimit RTSH programe cilësore. Aktivitete të rëndësishme të organizuara gjatë vitit 2019 janë:

Këste Kampionatit European te Futbollit, Europa League, Formula 1 etj.


Gjithashtu përfshihen këtu edhe shumë prodhime e bashkëprodhime, të cilat pjesërisht janë mbuluar nga financimi buxhetor e pjesërisht nga të ardhurat e veta.

- Zëri i Organizmave Ndërkombëtarë

Këtu përfshihen të gjitha shpenzimet që RTSH kryen ndaj organizmave ndërkombëtare, si Eutelsat, Ses Astra, për shërbimin satelitor, EBU për pagesat për transmetime në radio, televizion, lajme. Gjithashtu, në këtë zë përfshihen edhe pagesat e kuotizacioneve ndaj organizmave të tjerë ndërkombëtarë, si Circom, Copeam, Fiat, AFP, ERNO etj. Realizimi i këtij zëri gjatë vitit 2019 është në masën 99%.

- Zëri i Shërbimeve nga të tretë

Këtu përfshihen shpenzimet për shërbime të një natyre të përgjithshme që kryhen nga të tretët për funksionimin e përditshëm të veprimtarisë së RTSH-së, si shpenzimet për energji elektrike, ujë, shpenzimet telefonike, shpenzimet për ruajtjen e sigurisë fizike të objekteve të RTSH-së, qira të ambjenteve, pagesat për të drejtën e autorit, prodhimin e sinjalit TV, pagesat ndaj AKEP për frekuencat, si edhe shpenzime të tjera për prurësin e reklamës, trajnime, kontrata shërbimi etj. Realizimi i këtij zëri është në nivelin 95%.



- Zëri i shpenzimeve udhëtimi e dieta është realizuar 99%.

Në të gjitha njësitë e vartësise dhe gjatë vitit 2019 janë bërë edhe ndryshimet brenda strukturave, gjithmonë në vlerën e planifikuar në fillim të vitit.

- Zëri i shpenzimeve të tjera operative është realizuar në nivelin 99%.

Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për pritje dhe percjellje në Drejtorinë e Përgjithshme, shpenzimet për honorare në të gjitha njesitë e sistemit.

- Zëri i shpenzimeve për Investime

Investime në Teknologji. Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për investime në teknologji për:

- Blerje e furnizim pajisjesh për nevojat e transmetimit FM ~18 milion lekë.
- Blerje Led Wall dhe pajisje ndriçimi për studion e lajmeve ~ 41,6 milion leke.
- Furnizim-Vendosje depozita karburanti dhe sistem monitorimi për pikat e transmetimit në rrjetin DVB-T2 në vlerën ~ 47,6 milion lekë.

Kjo vlerë ishte parashikuar të financohej nga buxheti i shtetit në total, por u likuidua vetëm 50% nga fondet e buxhetit, pasi vlera 21 milion leke nga financimi buxhetor u përdor për të likuiduar detyrim pjesor për praktiken RTSH Agro, me miratimin e Ministrisë së Financave.

- Vlera 50 milion leke shtese nga buxheti i shtetit në fund të vitit 2019 u përdor për likuidimin e investimit RTSH Agro.
- Vlera 20,4 milion u përdor për UPS në studion levizese, furnizim për vendosje kabine elektrike në Zverec, furnizim dhe vendosje gjeneratore për nevojat e RTSH-së, krijimi i Web-it, HDD storage në transmetim etj.

- Zëri i shpenzimeve të mirëmbajtjes i parashikuar është realizuar në nivelin 100%, në vlerën e parashikuar.

Financimi buxhetor ka mbuluar vetëm 82% të shpenzimeve të këtij zeri, diferenca vijon të likuidohet gjatë tre viteve të fundit nga të ardhurat e vetë RTSH.

Kjo përqindje mosrealizimi vjen si efekt vetëm i ndryshimit të kursit të këmbimit Euro.

- Zëri i shpenzimeve të kësteve dhe interesave të kredisë është realizuar në kundërt detyrimit ndaj bankës gjermane për këstet e kredisë

Kredia është likuiduar tërësisht nga Ministria e Financave.

Krahasimi i shpenzimeve të RTSH-së gjatë tre viteve të fundit:

Emertimi	VITI 2017	VITI 2018	VITI 2019
Paga, shpërblime, sigurime shoqërore	788,897,000	782,181,000	783,440,000
Materiale, lëndë djegëse	49,699,000	65,724,000	64,785,000

Projekte filmike,artistike, prodhim i pavarur	245,190,000	331,000,000	338,287,000
Organizma Ndërkombëtare	119,950,000	76,000,000	86,967,000
Shërbime nga të tretë si energji elektrike, ujë, telekom, roje civile etj.	242,464,000	232,510,000	233,961,000
Shpenzime udhëtimi e dieta	78,859,000	75,606,000	86,498,000
Shpenzime të tjera operative (honorare, pritje përcjellje.etj)	51,308,000	85,207,000	60,811,000
Shpenzime për investime dhe mirëmbajtje rrjeti digjital i transmetimit	649,029,000	479,000,000	443,684,000
Shpenzime për interesa e këste kredie	291,000,000	340,000,000	326,000,000
TOTALI	2,516,396,000	2,467,228,000	2,424,433,000

Buxheti i këtij viti qëndron pothuajse ne te njejtin nivel me vitin e kaluar, me një ulje të vogel që është për investimet në teknologji, shpenzimet e tjera operative dhe shpenzimet për interesa e këste kredie.

Rritjet në zërat e tjerë janë rezultat i ndryshimeve strukturore programore për zërin e shpenzimeve të tjera operative (honoraret), projekte filmike e artistike, shpenzime udhëtimi etj.

Nisur nga ecuria e të ardhurave dhe shpenzimeve, RTSH gjatë gjithë vitit 2019 ka likuiduar vetëm shpenzimet e domosdoshme, si dhe ka ndjekur hap pas hapi situatën, për të realizuar detyrimet kontraktore.

RTSH e mbylli vitin 2019 me detyrime (borxhe) të larta ndaj të tretëve, si rezultat i të ardhurave të munguara gjatë tre viteve të fundit, relatuar në Këshillin e Ministrave dhe Ministrinë e Financave.

Aktualisht RTSH mbart detyrime në vlera tepër të larta (~435 milion lekë) për vitin 2019:

- kështu e kredisë të vitit 2018 edhe dy keshtet e vitit 2019 ~490 milion leke
- SLA e muajve tetor-nëntor 2019 në vlerën ~ 42 milion lekë
- Investime(përfshire RTSH AGRO) në vlerën ~50 milion lekë

Pa përfshire këtu detyrimet e krijuara në muajin dhjetor, të pritshme të realizohen në janar 2020.